



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of
Finance, Labour and Transfers.

Inspektorati i Punës / Inspektorata Rada / Labour Inspectorate

Nr. 01/08-173/2023-B/ *RUPJE*

Inspektori i Punës në MFPT- të Inspektoratit të Punës në Kosovë-Prishtinë, Agron Lolluni ID-1295 bazuar në dispozitën e nenit 94 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, të nenit 24 të Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë, Rregullores Nr.05/2014 MPMS për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendet e punës, Rregullores Nr.04/2014 MPMS për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, UA Nr.07/2012 (MPMS), nenit 13 të Ligjit Nr. 05/L-031 të LPPA, duke vendosur sipas vendimit të IP si organ i shkallës së dytë me Nr. 131/2023 të datës 04.04.2023, në procedurë të rivendosjes me datën 25.08.2023 merr këtë:

VENDIM
(Për shqiptimin e masës ndëshkimore)

Me vendimin Nr. 304/2023 të datës 06.07.2023, të Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së dytë, është shfuqizuar dhe i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje Organit të shkallës së parë.

Vendimi Nr. 304/2023, është nxjerrë në bazë të kërkesës të subjektit juridik Radio Televizioni i Kosovës sh.a e ushtruar ndaj vendimit Nr. 01/08-173/2022A të shkallës së parë dhe çështja i është kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë, me arsyetim se vendimi i shkallës së parë lidhur me sanksionimin e e dispozitës së nenit 4, paragrafit 3 dhe 2 të Ligjit të Punës 03/L-212.

Organi i shkallës ka konstatuar se lidhur me këtë pikë, organit i shkallës së parë nuk e ka arsyetuar pse është rregullorja në kundërshtim të dispozitës së nenit 4 paragrafit 3 dhe 2 të [Ligjit të Punës.

Inspektori i Punës duke ju përmbajtur udhëzimeve të dhëna në vendimin Nr. 304/2023, të komisionit si organ i shkallës së dytë, bënë administrimin e serish të të gjitha dokumenteve në lëndë si dhe në të njëjtën kohë lidhur me rishqyrtim sa më të sakët të lëndës, Inspektori i Punës ka proceduar në ri shqyrtim dhe ri vendosje vendimin me numër Nr.01/08-173/2022-Λ, dhe ka konstatuar se punëdhënësi është përgjegjës:

- I. Rregullorja për avancimet Nr. 0596/7 i datës 13.03.2017, është kundërshtim të dispozitës të Ligjit të Punës 03/L-212 neni 8, paragrafi 1 dhe 2. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).
- II. Avancimet duke u bazuar në neni 18 i rregullores Nr. 1325/18, janë në kundërshtim të dispozitës së Ligjit të Punës 03/L-212, Neni 4 paragrafit 3 dhe 2. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).
- III. Punëdhënësi duke mos e kryer vlerësimin e rrezikshmërisë të vendeve të punës, ka vepruar në kundërshtim të Ligjit Për Siguri dhe Shëndet në punë 04/L-161 Neni 16 dhe 17. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).
- IV. Punëdhënësi duke mos trajnuar punonjësit nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punës ka vepruar në kundërshtim të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-212 neni 20, paragrafët 1 dhe 2. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).
- V. Punëdhënësi me mos sigurimin e Kutia e ndihmës së parë, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë 04/L-161 neni 11 paragrafi 1. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€,(një mijë euro).
- VI. Punëdhënësi me mos sigurimin e Kontrolleve mjekësore për të punësuarit sipas kërkesë së Ligjit për siguri dhe Shëndet në punë 04/L-161 neni 22. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).

- VII. Punëdhënësi duke mos i ndërmarra masat për Siguri dhe Shëndet në punës sipas kërkesave të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punës 04/L-161 Neni 7 Masat parandaluese, paragrafëve 1, 2 dhe 6. I shqiptohet masa ndëshkimore në lartësi prej 1,000.00€ (një mijë euro).

Gjithsej, shqiptohet gjoba në lartësi: 7,000.00€ (shtatë mijë euro).

Obligohet personi juridik që në afat prej tetë ditësh nga pranimi i këtij Vendimi, për gjobën e shqiptuar ta merr Unirefin në zyrat e Inspektoratit të Punës dhe të paguaj në llogarinë bankare 1000430070006532, BQK duke u thirrur në numrin e këtij Vendimi. Dëftesa për kryerjen e pagesës merret në zyre të inspektoratit Rruga "Fehmi Agani" Prishtinë.

Kopjen e pagesës, në afat prej 8 (tetë) ditësh në vijim, duhet t'i prezantohet Inspektorëve të Punës, ose të dërgohet në adresë Rr."Fehmi Agani Nr.72, Prishtinë", në të kundërtën do të iniciohet procedurë përmbarimore.

Në bazë të nenit 6.4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe nr.03/L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës, nuk e shtyn ekzekutimin.

ARSYETIM

RTK sh.a ka parashtruar kërkesë për shfuqizimin vendimit 01/08-173/2022-A të datës, 27.02.2023.

RTK sh.a i është dorëzuar raporti zyrtar 01/08-173/2022, nga punëdhënësi me datë 09.11.2022 është pranuar përgjigja : Njëkohësisht marrim përsipër t'i adresojmë parregullsitë e konstatuara dhe t'i zbatojmë rekomandimet e nxjerra në këtë raport.

Datë 16.01.2023 Inspektorët e punës, janë takuar me zyrtaret e RTK-ës z. Shkumbin Ahmetxhekaj dhe Arsim Halilin, me te cilin rast është kërkuar të prezantohen provat në bazë të cilave do të dëshmohej se punëdhënësi ka filluar zbatimin e raportit zyrtar 01/08-173/2022, mirëpo deri me datën 27.02.2023 kur edhe është nxjerr vendimi, punëdhënësi nuk ka prezantuar ndonjë provë/shkresë se ka filluar të cvitoj pa rregulluesit e konstatuara në raportin në fjalë.

Duke ju përmbytur udhëzimeve të organit të shkallës së dytë, lidhur me ri shqyrtimin dhe ri vendosjen, lidhur me sanksionim e dispozitë së nenit 4, paragrafëve 3 dhe të ligjit të punës 03/L-212 lidhur me rregulloren Nr.

0595/17 datë 13.03.2017, e cila rregullore është evidentuar si pa rregulluci në raportin zyrtar 01/08-173/2022, Inspektorët e lëndës, pas rishqyrtimit të raportit të njëjtë, dhe ri shqyrtimit të pa rregullsisë së cekur, me rastin e nxjerrjes së vendimit 01/08-173/2022-A, të njëjtën pa rregullsi nuk e kanë sanksionuar me vendimin cekur, pasi e njëjta dispozitë e rregullores Nr. 0595/ 17, pas ri shqyrtimit, konsideron se në këtë rregullore janë përcaktuar më shumë të drejta, kushte dhe benifit për punonjësi, andaj e njëjta nuk është sanksionuar me vendimin 01/08-173/2023-A.

Në vendimin Nr. 304/2023, sa i për këtë dispozitave të tjera të cekuar në vendimin Nr. 01/08-173/2023-A, organi i shkallës së dytë, sa i për këtë konstatimeve të tjera lidhur me gjendjen faktike janë të drejta dhe të bazuara, dhe e ka refuzuar kërkesën e RTK sh.a si ta pa bazuar.

Inspektori Punës duke iu përmbajtur udhëzimeve të dhëna në vendimin Nr. 304/2023, të komisionit si organ i shkallës së dytë, bënë administrimin e serishëm të gjithë dokumentacionit në lëndë dhe pas rishqyrtimit dhe analizimit të rastit konstatohet gjendja faktike si në vijim:

RTK sh.a vepron duke u bazuar në këto akte ligjore:

- Ligji për RTK-në - Nr. 04/L-046
- Statuti i Radio Televizionit të Kosovës
- Rregullore për organizim të brendshëm
- Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës
- Rregullore për kompetencat dhe përgjegjësitë
- Metodologjia e Përcaktimit të Ndërlidhshmërisë së Vendeve të Punës
- Rregullore për kompensim/shpërblim për të punësuarit në RTK
- Rregullore për avancimin e të punësuarve në RTK
- Rregullore për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera
- Rregullore për udhëtimet zyrtare në RTK
- Rregullore për përgjegjësitë materiale dhe disiplinore
- Rregullore për procedurat dhe kriteret në përzgjedhjen e përmbajtjeve audio vizuale të producentëve të pavarur
- Rregullore për vlerësimin e rezultateve në punë për të punësuar
- Rregullore për Marketing
- Rregullore për Menaxhimin e Financave në RTK
- Rregullore për normat e punës në sektorin programor dhe për bashkëpunëtorët e jashtëm të RTK-së

- Rregullore për dhënie në shfrytëzim të materialeve arkivore
- Rregullore për punën e Bordit
- Rregullore për komunikim të brendshëm në mes të Bordit të RTK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm
- Rregullore për Auditim të Brendshëm
- Rregullore për menaxhimin e pasurisë jo financiare
- Rregullore për Shfrytëzimin e Veturave Zyrtare
- Rregullore për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së

Inspektimi i Objekteve të RTK-ës,

Gjatë inspektimit të objekteve të RTK-ës, është evidentuar se disa nga hapësirat e objekteve janë rinovuar, ju mungoj shenjat e SSIIP, në muret e objekteve janë të vendosura planet e evakuimit, në dy hidrantë mungojnë gypat e ujit, mungojnë shenjat e hidrantëve, korridoret si dhe shkallët janë të vendosura dollapët të cilët pengojnë qarkullimin e lirë.

Në objektin kryesor (administratës dhe Studiove), hyrja kryesore nuk është e niveluar (e dëmtuar) kabllot e rrymës dhe të tjera kablllo nga jashtë janë të pa izoluar, të pa rregulluara dhe qëndrojnë në ambient të hapur.

Në katin minus një, është i rinovuar dhe ka ajrosje, po ashtu janë rinovuar zyrat e redaktoreve.

Në objektet e RTK 2 dhe auto parkut, është evidentuar pa rregulluesi e mirëmbajtjes së hapësirave ku janë të vendosura trafo e rrymës, janë të bllokuara me materiale të zyrave (te thyera, të pa përdorshme), nuk ka shenja të daljes, në disa raste ka pragje në hyrje të zyrave të pa shënjuara, kabllot janë të pa siguruar në hyrje të zyrave, (të hapura), nxehëset janë të vendosura në patos (mbi tepihë) etj.

Në studiot e RTK sha, gjatë inspektimit është konstatuar se asnjëra nga studiot nuk ka dalje emergjente, nuk ka shenja të daljes, kabllot e kamerave dhe rrymës të lidhura me kamera janë në patos (të pa shënjuara), në studion në Auto park/RTK 2 qasja është e ngushtuar me orendi (rafte metalike dhe të drurit) , po ashtu rryma nuk është e mbyllur, plafoni i studios është e pa mirëmbajtur/dëmtuar, në njërin nga zyrat plafoni është i dëmtuar etj.

Në objektin ku gjendet Radio Kosova, gjatë inspektimit është konstatuar se në murrët e objektit janë të vendosura planet e evakuimit, kutit e ndihmës së parë janë të vendosura nëpër objekt mirëpo materiali është me afat të skaduar, ashensor nuk reagon (pas testimit , sinjaleve të rrezikshmërisë, ndalimit emergjent), në studiot e Radio Kosovës në patos është i vendosur tepihu (ka pluhur), në studio nuk ka ajrosje të mjaftueshme, ka lagështi,

kabllo e rrymës janë të pa rregulluara, plafoni është i dëmtuar në njërin nga studiot, disa shkallë të dëmtuara (linoleumi) etj.

Radio Televizionit të Kosovës sh.a:

RTK sh.a është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-046, me të cilin ligj rregullon themelimin, funksionimin dhe kompetencat për Radiotelevizionin e Kosovës, me qëllim të sigurimit të informimit të saktë, objektiv, të paanshëm dhe të shpejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Bazuar në dispozitën e Neni 4 Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës, paragrafit 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës dhe paragrafit 2. Kuvendi mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së të përcaktuar me këtë ligj.

Sipas kërkesë të punëdhënësit, Inspektorati i punës ka trajtuar ligjshmërinë e avancimeve dhe sistemimit të stafit, e cila çështje ka qenë edhe gjetje nga zyrës kombëtare e auditimit, punësimet dhe mënyrat e rekrutimit të stafit, dyfishimit (duplikimit/dyfishimit) të pozitive të udhëheqësve brenda njësisë, trajtimi i pozitive të punës që nuk janë paraparë në organogram dhe rregullore, dhe kontratat e punës,

Inspektorati i punës ka shqyrtuar pozitat e punës:

- Redaktor i edicionit - vendit të punës me shifrën Nr. 1041, koeficienti i pagës 4.36,
- Regjisor 1 (i parë) - vendit të punës me shifrën Nr. 1031, koeficienti i pagës 4.36,
- Gazetar 1 (i Parë) - vendit të punës me shifrën Nr. 1003, koeficienti i pagës: 3.62,
- Zyrtar i lartë i prokurimit - vendit të punës me shifrën Nr. 2583 koeficienti i pagës 4.78,
- Zyrtar i prokurimit - vendi i punës me shifrën 2043, koeficienti i pagës 3.79,
- Zyrtar i operativës financiare - Vendi i punës, me shifrën me Nr. 2561, koeficienti i pagës 3.79 Pikët,
- Redaktor i programit – vendi i punës me shifrën Nr. 2593, koeficienti i pagës 4.16,

Pas shqyrtimi akteve të brendshme, organogramit, rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, katalogut të vendeve të punës (pozitive) dhe kontratave të punës është evidentuar, se në katalog janë paraparë përshkrim i vendeve të punës, njohurit funksionale, koha e duhur për arritjen e njohurive funksionale, të dhënat për mbikëqyrjen, të dhënat mbi shkallën e përgjegjësisë dhe ndikimi në procesin e punës, të dhënat mbi përvojën e kërkuar të punës, të dhënat mbi punën e rëndësishme në vendin e punës, kërkesat psikike dhe sensorike, të dhënat mbi rrethinën e punës, të dhënat mbi orarin e punës.

Numri i punëtorëve (i pa përcaktuar), mirëpo bazuar në Ligjin për RTK-n, Nr. 04/L-046, sipas dispozitës të Neni 29 Kompetencat e Bordit të RTK-së, paragrafi 2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë, nën paragrafi 2.9. e shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim, është kompetencë e punëdhënësit të caktoj numrin e punonjësve për pozitat ekzistuese.

Pas shqyrtimit të akteve të brendshme të organogramit dhe katalogut të RTK-ës, është konstatuar se janë të parapara pozitat e punës, përshkrim i vendeve të punës dhe kriteret të cilat duhet ti posedoj një punonjës për atë pozitë.

Mirëpo, pas shqyrtimit të akteve të njëjta është konstatuar se punëdhënësi (RTK sh.a) nuk e ka të përcaktuar numrin e punëtorëve për pozitat e parapara në organogram dhe katalog të punës.

Punëdhënësi ka të punësuar 771 punonjës:

- 703 punonjës me kontrata me afat të pacaktuar.
- 67 punonjës me kontrata me afat të caktuar.
- 1 punonjës me kontratë me detyra specifike;
- 4 punonjës/bashkëpunëtorë të jashtëm me Kontrata për shërbime (2 prezantues dhe 2 përkthyes).
- Të punësuar meshkuj janë 63.12 %.
- Të punësuar femra janë 36.88 %.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-046 Neni 4 Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës, Neni 23 Financimi nga themeluesi Për sigurimin e bazave të veprimtarisë së paccnuar, aktiviteteve të rregullta dhe pavarësisë editoriale të RTK-së, si institucion i pavarur publik, themeluesi në varësi të mundësive buxhetore siguron mjete financiare, dhe Neni 29 Kompetencat e Bordit të RTK-së, paragrafit 2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë, nën paragrafit 2.9. e shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim, punëdhënësi është i detyruara të përcaktoj numrin e punonjësve për pozitat e parapara në aktet të brendshme, duke planifikuar nevojat e burimeve njerëzore për shkak të përdorimit të drejt dhe eficient të punonjësve.

Kontratat e punës me afat të pa caktuar të shqyrtuara nga Inspektorati i Punës konstaton se forma me shkrim është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-2012, Neni 10 Kontrata e Punës 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar.

Kontratat e punës me afat të caktuar të shqyrtuara nga Inspektorati i Punës konstaton se forma me shkrim është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-2012, Neni 10 Kontrata e Punës 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.2. një periudhë të caktuar.

Në nivel të RTK-së, në bazë të Marrëveshjes Kolektive Nr. Nr.0650/2020, punonjësi i cili ka rripëtirë kontratën e punës më shumë se tri vite, në bazë të dispozitës të neni 8, paragrafi 5. Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3)vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pa caktuar.

Inspektorati i punës konsideron se dispozita e Marrëveshjes Kolektive Nr. Nr.0650/2020, neni 8 paragrafi 5 është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-2012 Neni 4, paragrafi 3. Akti i Brendshëm i Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës mund të përmbajnë dispozita me të cilat përcaktohen më

shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me ligj, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Pas shqyrtimit të kontratës të vetme, për punë dhe detyra specifike, Inspektorati i Punës konstaton se marrëdhënia e punës e krijuar me shkrim është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-2012, Neni 10 Kontrata e Punës 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.3. për punë dhe detyra specifike.

Avancimet, sistemimi dhe ri sistemimi:

Sistemimet dhe ri sistemimet bëhen në bazë të dispozitës të Ligjit të Punës 03/L-212 Krenit III, Sistemimi i të punësuarit në vendin e punës, Neni 17 Caktimi i të punësuarit në vendin e punës 1. I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Punë. 2. Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuarit në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës. 3. I punësuarit sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive si dhe në bazë të paragrafit 4. E punësuarit gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë, e punësuarit me fëmijë deri në moshën tri (3) vjeç, prindi i vetëm me fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç, prindi i punësuarit me fëmijë me pengesa të rënda në zhvillim, i punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç si dhe i punësuarit me aftësi të kufizuara, nuk mund të sistemohen jashtë vendbanimit të tyre, pa pëlqimin e tyre.

Në bazë të kësaj dispozite i punësuarit caktohet në pozitën e punës në bazë të kontratës së punës, për të cilën pozitë është krijuar marrëdhënia e punës në formë të shkruar sipas kërkesë së dispozitës së Ligjit të punës neni 10, paragrafi 1 dhe 2.

Në rast të ristrukturimit apo organizimit të punës, punonjësi mund të sistemohet në vend tjetër të punës të i njëjti punëdhënës, mirëpo sistemimi i punonjësit në pozitë tjetër të punës mund të bëhet atëherë kur në organizatën punuese është aprovuar ristrukturimi apo ri organizimi sipas dispozitës të Ligjit të RTK-ës, Ligjit Nr. 04/L-046, Neni 29 Kompetencat e Bordit të RTK-së, paragrafit 2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë, nën paragrafit 2.9. e shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së

nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim, lidhur me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-212 neni 17 paragrafit 2.

Në RTK sh.a për periudhën e inspektimit për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, janë avancuar 127 punonjës, (sipas listave të prezantuara).

Avancimet në RTK sh.a janë bazuar në rregulloren për Avancimin e të punësuarave në RTK Nr. 0596/17 të datës 13.03.2017, e cila rregullore bazuar në Ligjin e RTK nenin 29, pika 2.2 dhe Statutit të RTK neni 36. Pika 7.

Pas shqyrtimit të akteve Ligjore është konstatuar se në Neni 29 Kompetencat e Bordit të RTK-së, paragrafi 2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë, 2.2. e aprovon rregulloren e punës së bordit si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me statut, të RTK-ës neni 36 Aktet e përgjithshme të RTK-ës, paragrafi 7 Rregullore për bisedat vjetore me të punësuarit.

Dispozitat e rregullores Nr. 0596/17, me të cilat krijohet një marrëdhënie e punës për një pozitë të re për të punësuarin, janë në kundërshtim të dispozitës së Ligjit të Punës 03/L-212, Neni 8 Konkursi Publik, paragrafit 1. Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës dhe paragrafit 2. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

Nga kjo që u tha krijimi i marrëdhënies së punës në sektorin publik krijohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës 03/L212 neni 8, paragrafët 1 dhe 2, lidhur me Udhëzimin Administrativ 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 4 paragrafit 6.

Pas shqyrtimit të rregullores Nr. 1325/18 për sistematizimin e vendeve të punës është konstatuar se kjo rregullore në preambula është thirrur në Ligjin 04/L-046 dhe Statutin e RTK-ës.

Në neni 18 është cekur se avancimet e punëtorëve në vende më komplekse (ngritja vertikale) dhe avancimet në vendin e njëjtë të punës (avancimet horizontale) përcaktohen me rregulloren të veçanet, kjo dispozitë është në kundërshtim të nenit 8 të Ligjit të Punës 03/L-212 lidhur me U.A 07/2017.

Të njëjtat pa rregulluesi lidhur me avancimet janë evidentuar edhe nga raportin e Auditorit në vitin 2019.

Kërkesë tjetër e punëdhënësit është: Mos evidentimi i stafit të punës,

Në bazë të shkresës së prezantuar, është konstatuar punëdhënësi posedon listat të evidentimit të stafit në punë, të gjeneruar nga Sistemi Elektronik i Evidentimit.

Në bazë sistemit të evidentimi elektronik, punëdhënësi mund të shqyrtoj hyrjet dhe daljet e punonjësve të RTK-ës.

Për ata punonjës të cilët nuk e respektojnë orarin e punës të përcaktuar në Kontratën e Punës sipas dispozitës të Ligjit të Punës 03/L-212 Neni 10 Kontrata e Punës, paragrafi 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas Neni 11 Përmbajtja e Kontratës së Punës, paragrafi 1. Kontrata e Punës përmban, nën paragrafi 1.5. orët dhe orarin e punës, atëherë punëdhënësi duhet të veproj sipas dispozitave të Ligjit të njëjtit Neni 85 Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës dhe Neni 86 Shqiptimin e masave

Kërkesë tjetër e punëdhënësit për shqyrtim ka qenë: Pagesat e pa rregullta të shujtës.

Bazuar në Marrëveshjes Kolektive Nr.0650/2020, Neni 58 Kompensimi i shpenzimeve për ushqim gjatë punës, paragrafët:

1. Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës me orar të plotë, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2.5 euro. Varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastin konkret do të rishikohet mundësia për rritje,
2. Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës,
3. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restoranti, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese 2.5 euro, të punësuarve për ushqim.

Inspektori i Punës pas shqyrtimit të bazës juridike të Marrëveshjes Kolektive konstaton se Marrëveshja Kolektive Nr. Nr.0650/2020 është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-212 neni 90 Marrëveshja Kolektive, paragrafët 1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë

në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.

Marrëveshja Kolektive Nr.0650/2020, është lidhur në mes punëdhënësit dhe përfaqësuesve të punonjësve, është në formë të shkruar, është në nivel të ndërmarrjes dhe është brenda afatit tre vjeçar (12.02.2022 e nënshkruar)

Në bazë të shkresë të prezantuar është konstatuar se punëdhënësi me rregull i kompenson shujtat në vlerë të 2.50€: Të gjithë të punësuarve të rregullt në nivel të RTK-së, i kompensohet shujta në vlerë prej 2.50 € bazuar në Marrëveshjen kolektive të RTK-së.

Punëdhënësi në kërkesën drejtuar Inspektoratit të Punës ka kërkuar shqyrtimin:

Kompensimi dhe shpërblimi i stafit të rregullt, harmonizimi i rregulloreve të brendshme me Ligjin e Punës,

Në bazë të shkresë të prezantuar, është konstatuar se RTK sh.a ka nxjerrë rregulloren për kompensimin/shpërblimin për të punësuarit në RTK Nr. 0595/17 datë 13.03.2017.

Pas shqyrtimit të rregullore Nr. 0595/17 është konstatuar se në preambula punëdhënësi është thirr gabimisht në bazën juridike me rastin e nxjerrjes të kësaj rregullore.

Në preambulë punëdhënësi është thirru në Ligjin për RTK nenin 29. Pika 2.2, nxjerrja e akteve të brendshme është Kompetencë e Bordit të Drejtorëve, i cili nën paragraf më tej thotë: 2.2, e aprovon rregulloren e punës së bordit si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me statut, mirëpo punëdhënësi duke u thirre në dispozitat e Statutit neni 36, pika 11, ka vepruar në kundërshtim të vetë statutit, pasi në pikë 11 të statutit, është paraparë rregullorja për auditimin e brendshëm.

Siç u cek më lartë ne këtë vendim, Inspektori i lëndës, në dallimi kur në raportin zyrtar e ka konstatuar si pa rregullsi, kompensimin në vlerë të 30% më shumë, kur punonjësit zëvendësoj kolegen gjatë orarit të njëjtë të punës, e paraparë ne rregulloren Nr. 0595/2017 neni 10.

Duke ju përmbajtur udhëzimeve të organit të shkallës së dytë, lidhur me ri shqyrtimin dhe ri vendosjen, lidhur me sanksionim e dispozitë së neni 4, paragrafëve 3 të ligjit të punës 03/L-212 lidhur me rregulloren Nr. 0595/17 datë 13.03.2017, e cila rregullore është evidentuar si pa rregulluesi në raportin zyrtar 01/08-173/2022, Inspektori i lëndës, pas rishqyrtimit të

raportit të njëjtë, dhe ri shqyrtimit të pa rregullsisë së cekur ne raport zyrtar, me rastin e nxjerrjes së vendimit 01/08-173/2022-A, të njëjtën pa rregullsi nuk e kanë sanksionuar me vendimin cekur, pasi e njëjta dispozitë e rregullores Nr. 0595/ 17, pas ri shqyrtimit, IP konsideron se ne dispozitne e nenit 10 tw rregullores 0595/17 janë përcaktuar më shume të drejta, kushtë dhe benifit për punonjësi, andaj e njëjta nuk është sanksionuar me vendimin 01/08-173/2023-A dhe nuk do te sanksionohet me vendimin 01/08-173/20222-B

Pushimi i Lchonisë,

Në bazë të vendimeve për pushim të lehonisë për periudhën inspektuese, është konstatuar se 13 punonjësve kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.

Pushimet pa pagesë,

Në bazë të vendimeve të prezantuara është konstatuar se gjatë periudhës inspektues, 17 punonjës kanë shfrytëzuar pushimet pa pagesë.

Siguria dhe Shëndeti në Punës,

Punëdhënësi nuk posedon vlerësimin e rrezikshmëri të vendeve të punës sipas kërkesë të Ligjit Për Siguri dhe Shëndet në punë 04/L-161 Neni 16 Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës, paragrafi 1. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës dhe paragrafit 2. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi.

Zyrtari për SSHP,

Në RTK, ka të punësuar një zyrtar për Siguri dhe Shëndet në Punë, me certifikatën Nr. 207/2019 i datës 10.12.2019, është në harmoni me dispozitën e Ligjit për SSHP 04/L-161 Neni 10 Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

Kutia e ndihmës së parë,

Gjatë inspektimit të objekti të Radio Kosovës, është konstatuar se fashat (materiali i kutisë së Ndhmës së parë), i ka skaduar afati në vitin 2013, 2015 etj.

Aparatet për fikjen e zjarrit,

Punëdhënësi posedon aparate për fikjen e zjarrit në numër të mjaftueshëm, gjatë inspektimit është konstatuar se punëdhënësi për mirëmbajtjen e aparateve për fikjen e zjarrit ka ta angazhuar subjektin juridik Ko“ Besarti Servise” nga Vushtrri si dhe ka 6 punonjës të trajnuar për përdorimin e aparateve për fikjen e zjarrit.

Trajnimi nga fusha e Siguri dhe shëndetit në punë,

Punëdhënësi nuk i ka trajnuar punonjësit nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në punës, sipas kërkesë së dispozitës të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-161 Neni 20 Trajnimi i të punësuarve, paragrafi 1. Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si: 1.1. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës; 1.2. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës; 1.3. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës; 1.4. në rast të përdorimit të teknologjisë së re; 1.5. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme dhe paragrafit 2. Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij.

Kontrollet mjekësore,

Punëdhënësi për veç kur pranohen në punë, punonjësit prezantoj raportet mjekësore, mirëpo punëdhënësi nuk ka siguruar kontrollet mjekësore sipas Ligjit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 04/L-161 Neni 22 Kontrollimet mjekësore, paragrafi 1. Punëdhënësi është i detyruar t’iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës në pajtim me paragrafin 5. të nenit 17 të këtij ligji dhe paragrafit 2. Punëdhënësi është i detyruar t’i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vite.

Inspektori i punës pas rishqyrtimit të të gjitha konstatimeve të bëra nga organi shkallës së dytë dhe administrimit të serishëm të shkresave të lëndës ka nxjerr vendimin 01/08-173/2022-B.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: kundër këtij vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh, T E të Inspektoratit të Punës në Kosovë , nëpërmes Inspektorëve të Punës në Prishtinë, Rruga e "Fehmi Agani Nr. 72.

Në bazë të nenit 6.4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe nr.03/L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës, nuk e shtyn ekzekutimin.

_____/_____/_____

v.v

Inspektori i punës

